

LIBRI VERDHË, SHTËPIA E VERDHË DHE RAPORTI I ZI

Nga **Xhavit Shala**

Raporti i paraqitur disa ditë më parë nga parlamentari i Këshillit të Evropës,¹ ish prokurori zviceran Dik Marti, në të cilin akuzoheshin për krime të rënda UÇK-ja dhe ish udhëheqësi i saj, Hashim Thaçi, tërhoqi vëmendjen e shumë qarqeve politike evropiane rajonale dhe me të drejtë shkaktoi një reagim të ashpër politik e institucional në Kosovë dhe Shqipëri e në të gjithë hapësirën shqiptare. Gjykuar nga momenti kur raporti u hodh ne “treg” dhe impakti që pati kjo intrigë e radhës për Kosovën, del se libri i verdhë i Karla del Pontes për të ashtuquajturën “shtëpi të verdhë” si dhe raporti i zi i Dik Martit kanë cenuar imazhin e shtetit të ri të Kosovës, imazhin e Shqipërisë, interesat tona kombëtare si dhe gjeopolitikën e shqiptarëve në rajon.

Akuzat e Dikut nuk janë të reja. Sidomos ajo për trafik organesh. Edhe më parë, një bashkëpatriote dhe ish kolege e Dik Martit, Karla Del Ponte, hodhi akuza për UÇK-në, duke e akuzuar atë deri për rrëmbim civilësh serbë, transportimin e tyre në Shqipëri si dhe vrasjen dhe trafikimin e organeve të tyre. Del Ponte “gjeti” dhe “shtëpinë e verdhe” afër Burrelit, ku, sipas saj ishin realizuar këto veprime. Ajo, gjatë kohës që ishte në detyrë si kryeprokurore e Hagës, kishte të tërë autoritetin dhe kapacitetet e duhura për të hetuar këto akuza, por pasi nuk e bëri dot dhe vetëm pasi mbaroi mandatin e saj si kryeprokurore në Hagë, ajo i bëri publike këto akuza të pa vërtetuara në librin e saj të verdhë “Gjuetia: unë dhe kriminelët e luftës” (La caccia - Io e i criminali di Guerra)

Dhe provat e “pakundërshtueshme” që në atë kohë Del Ponte pretendonte se i kishte për transplantin e organeve në “shtëpinë e verdhe” ajo i bëri publike në një intervistë dhënë medieeve më datë 18.12.2010 “Diçka mjekësore kishte ndodhur.. Ka pasur prova gjaku, shami, fotografi dhe gjëra të tilla të ngjashme”. Të bësh akuza monstruoze publike me të tilla informacione të paverifikuara, vetëm për profesionalizëm prokurori nuk mund të flitet. Megjithatë, “Prokurorët dhe hetuesit e EULEX-it e kanë hetuar rastin e të ashtuquajturës ‘shtëpi të verdhë’... deri më sot ata nuk kanë gjetur ndonjë provë që do t’i bënte të besonin se në atë vend është kryer heqje organesh” deklaroi ditë më parë Blerim Krasniqit, zëdhënës i Eulex-it.

Por, pas Karla Del Pontes, ish prokurori tashmë politikan Dik Marti, bazuar në librin e verdhë të Del Pontes, pretendon se ka mbledhur informacione dhe ka gjetur se përgjegjës për atë çka ndodhi në “shtëpinë e verdhe” është Hashim Thaçi dhe udhëheqës të tjerë te UÇK-së. Në kundërshtim me etikën e çdo

¹ Artikulli është botuar në të përditshmen “Koha Jonë” datë 22.12.2010

prokurori, informacionet të cilat nuk kanë mundur të vërtetohen nga hetimet e Gjykatës së Hagës dhe të vetë Eulexi-t, Dik Marti i amplifikon ato politikisht dhe i kthen në një raport të zi jo vetëm për UCK-në, Hashim Thaçin e Kosovën, por edhe për Shqipërinë dhe gjithë shqiptarët, raport të cilin ia servir Këshillit të Evropës. "Mendoj se është për të ardhur keq që ato janë botuar sikur të jenë prova dhe jo akuza. Mendoj se toni i raportit është i gabuar... Raporti i KE-së nuk sjell argumente për akuzat e bëra.. Shumë nga ato që thuhet në raport, janë fjalë që kanë qarkulluar. Veçanërisht për akuzat se zyrtarë të lartë qeveritarë kanë qenë të përfshirë, nuk paraqiten prova në raport", thotë Daniel Serwer, një nga analistët më të shquar të çështjeve ballkanike.

Në të vërtetë edhe para këtij raporti, Dik Marti nuk e ka fshehur pozicionin e tij antikosovar, antishqiptar dhe pro interesave serbe. Rreth dy vjet më parë ai doli hapur kundër pavarësisë së Kosovës. Ai në atë kohë u shpreh se "Konstatohet se Kosova e administruar nga komuniteti ndërkombëtar pas 10 vjetësh ka një ekonomi që nuk ekziston, është kthyer në një qendër të krimit të organizuar e të trafikut të drogës, armëve dhe qenieve njerëzore. Konstatohet se nuk ka një shoqëri të vërtetë civile e cila të ngrejë themelet e një demokracie të vërtetë...".

Nëse Dik Marti do të ishte i interesuar seriozisht për të zbuluar të vërtetën, si ish prokuror, ai nuk duhet të paragjykonte dhe të akuzonte pa prova struktura apo dhe persona të veçantë, por mjaftonte të këmbëngulte për fillimin edhe një herë të hetimeve për këtë çështje dhe si politikan të gjente mekanizmat ligjorë për ta realizuar atë. Mënyra se si veproni Dik Marti, komprometon plotësisht nismën e tij dhe tregon se prapa veprimeve të tij janë motive të tjera. Dhe cilat mund të jenë këto?

Zoti Marty, është i njohur për tendencën e tij për sensacione, për të ngritur diçka nëse nuk ka prova, një demagog që keqpërdor pozitën e tij. Kështu e përshkruan atë në një intervistë dhënë programit shqip të Deutsche Welle me datë 17.12.2010, kolegu i tij, deputeti i Partisë Popullore Evropiane në Parlamentin Evropian Bernd Posselt. Mund të mendohet se Dik Marti i bëri këto për të rikthyer dhe një herë lavdinë e tij pas denoncimeve të burgjeve të paligjshme të CIA-s në Evropë. Kjo mund të jetë e vërtetë.

Por më shumë të fituar se sa zoti Marti, nga publikimi i këtij raporti dolën serbët, çka te nxit të investigosh për bashkëpunimin e tyre me Dik Martin. Kjo nisur nga pozicioni i mëparshëm antishqiptar dhe pro serb i Dik Martit si dhe nga deklarata e vetë presidenti serb Boris Tadiq, më 20.12.2010, në të cilën ai shprehet se : "Serbia e ka pritur me vite për një raport të tillë. Pas publikimit të raportit të Dik Martit, problemi i Kosovës do të shihet nga një prizëm tjetër nga ana e komunitetit ndërkombëtar... Tash, është një pamje tjetër dhe për këtë i falënderohem Dik Martit... populli serb, gjatë viteve të kaluara, në opinionin

ndërkombëtar është paraqitur si fajtori i vetëm për të gjitha ngjarjet në ish RSFJ-në. Por, pas raportit të Martit, sipas tij, një qëndrim i tillë “bie në ujë”.

Sipas fakteve të publikuara tashmë wshtw e vërtetuar dhe pranuar publikisht se Serbia ka vite qe punon me Zotin Dik Marti për përpilimin e një raporti të tillë. Këtë e pohon Bruno Vekariq, zëvendës prokuror për krimet e luftës. Sipas tij përfaqësuesit e Prokurorisë serbe shumë herë janë takuar me Dik Martin, me të cilin kanë shkëmbyer informacione. “Nëse shikoni raportin do të shihni se pjesa që ka lidhje me strukturën e organizimit të UÇK-së është pjesë e marrë nga raporti ynë, që kemi dërguar ne. Po ashtu në raport ndodhen edhe pjesët që i kemi dhënë ne për dëshmitë lidhur me trafikimin e organeve njerëzore si dhe lidhjen e krimit të organizuar me qarqet politike” (DW-World 17.12.2010).

Gjithashtu Bruno Vekariq nuk heziton te deklaroje se “përmes hartave dhe emrave të vendeve që i ka dhënë pala serbe, Dick Marty ka shkuar në disa vende të caktuara dhe ka pyetur autoritetet lokale, të cilat pala serbe nuk ka mundur t'i marrë në pyetje". Bile kryeprokurori i Serbisë për krime lufte Vladimir Vukçević arrin deri aty sa raportin e Dick Martit e paraqet një fitore të madhe dhe për punën e tij personale.

Pra prokuroria dhe sherbimet sekrete serbe gjejnë dëshmitarët, i instruktojnë dhe ja bëjnë gati ti pyes Zoti Dik Marti, i cili më pas ne mënyrë krejt te papërgjegjshme, duke abuzuar me detyrën e parlamentarit evropian, i përfshin ato në raporte politike ne emër të KE-se.

Pas dështimit në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë për çështjen e Kosovës, Tadiqi tashmë është i gëzuar se raporti i Dik Martit ka paraqitur edhe shqiptarët fajtor si serbet ne ish RSFJ. Kështu, Diku, me raportin e tij i ngushëllon disi kriminelet serb te luftës, duke i barazuar ata me viktimat. Këtë gjë ne te vërtetë synoi të arrinte edhe Karla Del Ponte disa vite me pare. Kryeprokurorja e asaj kohe e Hagës, e emëruar për të goditur krimet e luftës, me veprimet e saj gati sa nuk provokoi luftë në Kosovë, kur barazoi Ramush Haradinajn me Millosheviçin.

Ne vitin 2005, akuzat e saj ndaj zotit Haradinaj u komunikuan pikërisht në kohën kur ai po punonte intensivisht dhe po arrinte suksese në drejtim të realizimit të pjesës më të madhe të standardeve të vendosura nga Grupi i Kontaktit, sidomos ato të sigurisë për pakicat. Ishte pjekuria dhe besimi i zotit Haradinaj në pafajësinë e tij, besimi ndaj Tribunalit të Hagës e vendimi për t'u dorëzuar vullnetarisht atje, thirrja që ai i drejtoi popullit të Kosovës për të ruajtur qetësinë, pjekuria e shoqërisë kosovare, e cila i kuptoi drejt mesazhet e kryeqeveritarit të saj si dhe gadishmëria e KFOR-it, faktorët që parandaluan destabilizimin e atëhershëm në Kosovë.

Si përfundim Zoti Dik Marti me raportin e tij, dëmtoi imazhin e shtetit të ri të Kosovës, imazhin e Shqipërisë, interesat tona kombëtare si dhe gjeopolitikën e shqiptarëve në rajon. Për të minimizuar dëmet që kjo mund ti shkaktojë më tej çështjes së Kosovës si dhe çështjes kombëtarë shqiptare në përgjithësi si dhe për të ndërprerë çdo përpjekje serbe për të revizionuar përkrahjen perëndimore për pavarësimin e Kosovës dhe njohjen e mëtejshme ndërkombëtare të saj, përveç një aksioni të fuqishëm diplomatik të qeverisë së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës, është i nevojshëm një hetim i shpejtë e i besueshëm i akuzave të Dik Martit.

Për këtë, më një letër porosi drejtuar autoriteteve gjyqësore zvicerane, të kërkohet pyetja në cilësinë e personave që kanë dijeni për rrethanat e hetimit të shtetasve zviceran Karla Del Ponte dhe Dik Marti. Njëkohësisht të kërkohet bashkëpunim dhe me Prokurorinë e Eulexi-t dhe atë serbe. Vetëm duke i sqaruar përfundimisht dhe ndërkombëtarisht akuzat, libri i verdhe i Karla Del Pontes, shtëpia e verdhe afër Burrelit dhe raporti i zi i Dik Martit nuk do të rendojnë me mbi qafën e shqiptarëve.